



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni Pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 35  
Prishtinë, më 23 janar 2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Albert Kinolli, Avdullah Hoti, Emilija Rexhepi dhe Ali Lajçi.

**Munguan:** Faton Topalli, Valon Ramadani, Etem Arifi, Andin Hoti dhe Verica Qeraniq.

**Stafi mbështetës:** Antigona Ibraj, Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Dhurata Kryeziu nga OSBE, Besiana Bajrami nga Ekonomia Online, Brikena Mazrekaj nga KDI dhe Vatra Qehaja nga LVV.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.12.2018;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të Punës së KMFP-së për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i draft- Planit të Punës së KMFP-së për vitin 2019;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.12.2018**

*Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 19.12.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të Punës së KMFP-së për vitin 2018**

**Kryetari** njoftoi deputetët se administrata e komisionit ka përgatitur raportin vjetor të punës së komisionit për vitin 2018 për periudhën kohore janar–dhjetor 2018, të dhënat janë të pasqyruara në detale. Tha se KMFP ka mbajtur 26 mbledhje të komisionit, ka shqyrtuar 34 raporte të auditimit, ka shqyrtuar dy projektligje, ka mbajtur 3 dëgjime publike dhe po ashtu ka mbajtur tri punëtori. KMFP gjatë vitit 2018 nuk ka monitoruar asnjë projektligj. Me këtë hapi diskutimin dhe ftoi anëtarët e komisionit nëse kanë diçka për të shtuar lidhur me këtë pikë.

**Avdhullah Hoti** theksoi se KMFP nuk ka arritur të shqyrtojë një numër më të madh të raporteve të auditimit të jashtëm të përgatitura nga Zyra Kombëtare e Auditimit për shkak se një numër i ministrave nuk janë përgjigjur ftesës së komisionit, si: ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, ministri i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit, ministri i Ministrisë së Arsimit etj. Po ashtu kryetarët e komunave nuk ju kanë përgjigjur ftesës së Komisionit për Dëgjim Publik, për të shqyrtuar raportet e auditimit të jashtëm për vitin 2017.

**Mërgim Lushtaku** theksoi se në raportin vjetor të punës së komisionit për vitin 2018 kishte me qenë mirë që në formë tabelare të paraqiten lista e raporteve të shqyrtuara, si dhe lista e rekomandimeve që ka dhënë komisioni. Kjo për faktin që deputetët dhe lexuesit të tjerë të orientohen me lehtë.

### *Përfundim*

*KMFP aprovoi Raportin Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2018.*

## **4. Shqyrtimi i draft- Planit të Punës së KMFP-së për vitin 2019**

**Kryetari**, me këtë pikë, i njoftoi deputetët se administrata e komisionit ka përgatitur planin e punës së komisionit për vitin 2019, për periudhën janar-dhjetor 2019, së bashku me planin financiar në nivel të aktiviteteve, këtij plani do t'i shtohen edhe lista e raporteve të auditimit, të cilat komisioni planifikon t'i shqyrtojë gjatë vitit. Me këtë e hapi diskutimin.

**Avdullah Hoti** theksoi se plani i punës së komisionit për vitin 2019, për muajin janar dhe shkurt thotë se KMFP do të shqyrtojë raportet e Auditimit të vitit 2017, mendoi se ne, si komision, duhet të fillojmë me shqyrtimin e raporteve të auditimit të vitit 2018, si dhe planet e veprimit për adresim të rekomandimeve. Po ashtu propozoi që gjatë muajit mars, KMFP të organizojë një konferencë rajonale me kryetarët e komisioneve të vendeve në rajon, si dhe t' i ftojë në këtë konferencë kryetarët e Gjykatave të Auditimit të vendeve në rajon, si dhe përfaqësues të Komisionit Evropian. Shpenzimet nga ky organizimi të sigurohen nga buxheti i komisionit, si dhe të shikohet mundësia që GIZ të

ndihmojë në këtë proces. Po ashtu administrata e komisionit duhet të shikon që në planin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2019, cilat projektligje janë dhe cilat bien në fushëveprim të komisionit. Po ashtu theksoi se gjatë vitit 2019 është mirë të kemi së paku 2 vizita jashtë vendit për të parë përvojat e vendeve të tjera në këtë fushë.

**Kryetari** shtoi se nga ZKA gjatë vitit 2019 duhet të presim që kërkesat e komisionit do të realizohen. Po ashtu nga ZKA dhe GIZ presim që përveç raporteve të auditimit dhe komenteve në raporte të na sigurojë edhe informacione të tjera, që lidhen me fushën e Financave Publike sipas kërkesës së komisioni.

### *Përfundim*

*KMFP aprovoi Planin e Punës së Komisionit për vitin 2019, së bashku me planin financiar.*

## **5. Të ndryshme**

**Kryetari** theksoi se me kërkesën e disa deputetëve të komisionit, ne ju kemi drejtuar MKK, MZHR dhe MBPZHR për të na përgatitur një raport financiar lidhur me mënyrën e buxhetimit, ndarjes dhe shpenzimit të subvencioneve për periudhën kohore tetor 2017 deri në muajin tetor 2018. Megjithatë deri me datën e sotme, ne nuk kemi pranuar raportin e kërkuar. Me këtë hapi diskutimin

**Emilija Rexhepi**, ashtu siç theksoi edhe kryetari i komisionit, se puna e komisionit për mbikëqyrje të financave publike është e fokusuar vetëm në raportet të auditimit të jashtëm e të cilat zakonisht bëhen pasi të jenë mbyllur periudha kohore e raportimit. Rasti konkret i kërkesës sonë për raport financiar nga MKK, MZHR dhe MBPZHR për një raport financiar për mënyrën e buxhetimit dhe ndarjen së subvencioneve. Mos raportimi me kohë e humb edhe rëndësinë e kërkesës sonë. KMFP duhet të jetë ndihmesë edhe për komisionet e tjera funksionale të Kuvendit. Institucionet e nivelit qendror dhe ato të nivelit lokal presin nga KMFP dhe komisionet e tjera funksionale të Kuvendit për një kontroll me të mirë ndaj këtyre institucioneve, rasti konkret disa herë ne kemi ftuar në raport MKK, por nuk ju janë përgjigjur ftesës së komisionit. Ne kemi informacione se nuk zbatohet asnjë kriter i dhënë me procedura të prokurimit për mënyrën e shpërndarjes së projekteve në këtë ministri te përfituesit individual. Kjo për fat të keq është në disa institucione. Mendoj se këto çështje ne duhet t'i ngritin në nivel të Seancës Plenare.

**Albert Kinolli** theksoi se niveli i raportimeve të ministrave në komision nuk është i kënaqshëm. Ne, si komision, duhet të vendosmi se si të ngremë nivelin e përgjegjësisë në nivel të institucioneve.

**Kryetari** theksoi se në mbledhjen e radhës së komisionit do të vendoset, se cilat raporte do t'i shqyrtojmë dhe si do të procedojmë tutje me raportet e MKK, MZHR dhe MBPZHR. Me këtë e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Driton Selmanaj**